Архивски знак: 0201
Shenja arkivore:
Рок на чување: 1
Afati i ruajtjes:
01.04 2025 година
Потпис Nënshkrimi
Врз основа на член 36 ст

KOPJE ARKIVORE
EKZEMPLAR ARKIVOR

Н.У.ОРКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РСМ
НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА
ОРКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
INSTITUTI NACIONAL
ORKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 02 - 227/10
01. 04. 20 25 год.-viti

Në bazë të nenit 26, paragrafi (1) pika 11 e Ligjit të Kulturës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 15/2008, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 39/2016 dhe 11/2018) dhe nenit 21, paragrafi (1), pika 11 të Statutit të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz" – Shkup, në mbledhjen e 14-të, të mbajtur më 1.4.2025, u miratua kjo:

RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN E RIAUDICIONIT NË SHKUP

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, mënyra dhe procedura për zbatimin e riaudicionit (vlerësimit të efektit çdo 3 vjet) të artistëve të kategorisë A, në Orkestrën e Muzikës Xhaz.

Artistët e kategorisë A, të cilët kanë 10 (dhjetë) vjet deri në realizimin e të drejtës për pension, përjashtohen nga paragrafi 1 i këtij neni, përkatësisht efekti i tyre nuk vlerësohet nëpërmjet zbatimit të procedurës së riaudicionit.

Neni 2

Procedurën për realizimin e riaudicionit e zhvillon komisioni i formuar nga drejtori.

Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, artistë të shquar të një niveli më të lartë se niveli i kandidatit për të cilin zhvillohet procedura e riaudicionit.

Drejtori, brenda afatit prej 5 (pesë) ditësh, miraton aktvendim në bazë të propozimit të komisionit, me të cilin përcaktohet nëse artisti e ka kaluar ose nuk e ka kaluar riaudicionin.

Vlerësimi i efektit (riaudicioni)

Neni 3

Komisionet kryejnë riaudicionin për vlerësimin e efektit të artistëve të kategorisë A, sipas disa kritereve të përcaktuara nga drejtori.

Komisionet mund të përcaktojnë edhe kritere shtesë ndihmëse.

Neni 4

Para fillimit të riaudicionit, komisionit i dorëzohen formularët e përgatitur paraprakisht, në të cilët janë shënuar të dhënat personale të personit që vlerësohet, së bashku me kriteret e detyrueshme për kontrollim.

Çdo anëtar i komisionit i shpreh rezultatet e kontrollit për secilin kriter me një vlerësim nga 1 (një) deri në 5 (pesë), për secilin artist veçmas.

Çdo artist (ofrues shërbimi) e kalon riaudicionin nëse ka një vlerësim mesatar ose më të lartë se 3 (tre).

Komisioni i përmbledh rezultatet me një procesverbal të veçantë.

Procesverbalin me vlerësimet nga riaudicioni, komisioni ia dorëzon drejtorit për secilin ofrues shërbimi veçmas, brenda afatit prej 1 (një) dite, përkatësisht ditën e ardhshme të punës.

Neni 6

Artisti i cili e ka kaluar riaudicionin, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i riaudicionit, me vendim caktohet në të njëjtin vend pune ose mund të caktohet edhe në një vend pune më të lartë, në përputhje me Aktin për sistematizimin e vendeve të punës të IN "Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së".

Artisti i cili nuk e ka kaluar riaudicionin, me aktvendim caktohet në të njëjtin vend pune dhe është i obliguar që brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh të hyjë në riaudicion të ri.

Nëse edhe për herë të dytë nuk e kalon riaudicionin, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh artisti, me aktvendim, do të caktohet në një vend pune më të ulët në institucion. Në rastin nga paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje, për artistin i cili është caktuar në një vend pune më të ulët, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh do të organizohet riaudicion i përsëritur.

Nëse edhe për herë të tretë nuk e kalon riaudicionin, drejtori do të miratoj aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së artistit. Por, nëse e kalon riaudicionin e përmendur, drejtori me aktvendim e sistemon në vendin e punës ku ka qenë para dhënies së riaudicionit të parë.

Neni 7

Pas pranimit të aktvendimit për sistemimin nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, artisti ka të drejtë të paraqesë kundërshtim pranë Këshillit drejtues.

Këshilli drejtues, brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh, vendos lidhur me kundërshtimin e paraqitur.

Artisti i pakënaqur me vendimin e Këshillit drejtues mund të paraqesë padi pranë gjykatës kompetente.

Padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe publikimit në faqen e internetit të Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së.

Претседател на Управен Одбор

Сашко Николовски